



International
Labour
Organization



Funded by
the European Union

► Udhëzues mbi përcaktimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve për kontaktimin (outreach) e të rinjve në kontekstin e Garancisë Rinore



© Organizata Ndërkombëtare e Punës 2025.
Publikuar për herë të parë 2025.



Attribution 4.0 International (CC BY 4.0)

Ky material është i licencuar sipas Creative Commons Attribution 4.0 International. Shih: creativecommons.org/licenses/by/4.0. Përdoruesve u lejohej ta ripërdorin, shpërndajnë (kopjojnë dhe rishpërndajnë), përshtatin (rimiksojnë, transformojnë dhe ndërtojnë mbi materialin origjinal), siç përcaktohet në licencë. Përdoruesi duhet të japë në mënyrë të qartë kredite ILO-së si burim i materialit dhe të tregojë nëse janë bërë ndryshime në përmbajtjen origjinale. Përdorimi i emblemës, emrit dhe logos së ILO-së nuk lejohej në lidhje me përkthime, përshtatje apo punime të tjera derivuese.

Attribution – Përdoruesi duhet të tregojë nëse janë bërë ndryshime dhe duhet të citojë punimin si më poshtë: ILO, *Udhëzues mbi përcaktimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve për kontaktimin (outreach) e të rinjve në kontekstin e Garancisë Rinore*, Geneva: Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2025. © ILO.

Përkthimet – Ky është një përkthim i një produkti me të drejta autori të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Përshtatjet – Në rast përshtatjeje të këtij materiali, duhet të shtohet shënimi vijues së bashku me atributimin: Kjo është një përshtatje i një produkti me të drejta autori të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Kjo përshtatje nuk është përgatitur, shqyrtuar apo miratuar nga ILO dhe nuk duhet të konsiderohet si përshtatje zyrtare e ILO-së. ILO heq dorë nga çdo përgjegjësi për përmbajtjen dhe saktësinë e saj. Përgjegjësia bie vetëm mbi autorin(ët) e përshtatjes.

Materialiet e palëve të treta – Kjo licencë Creative Commons nuk zbatohet për materialet me të drejta autori që nuk janë të ILO-së, të përfshira në këtë botim. Nëse materiali i atribuohet një palë të tretë, përdoruesi i atij materiali është plotësisht përgjegjës për marrjen e të drejtave nga mbajtësi i të drejtave dhe për çdo pretendim për shkelje..

Çdo mosmarrëveshje që lind sipas kësaj licence, e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje, do t'i referohet arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare (UNCITRAL). Palët do të jenë të detyruara nga çdo vendim arbitrazhi i dhënë si rezultat i këtij procesi, si gjykimi përfundimtar i mosmarrëveshjes.

Për detaje mbi të drejtat dhe licencimin, kontakton: rights@ilo.org. Për detaje mbi botimet dhe produktet digjitale të ILO-së, vizitoni: www.ilo.org/publns.

ISBN: 9789220429570 (PDF)

Gjithashtu i disponueshëm në: Anglisht: *Guidelines on setting minimum service delivery standards for youth outreach in the context of the Youth Guarantee*, ISBN 9789220429563 (PDF);

Boshnjakisht: *Smjernice o određivanju minimalnih standarda za pružanje usluge dosezanja do mladih u kontekstu Garancije za mlade*, ISBN 9789220429587 (PDF);

Maqedonisht: *Насоки за утврдување минимални стандарди за младински теренски активности во контекст на Гаранцијата за млади*, ISBN 9789220429594 (PDF);

Malazezisht: *Smjernice o određivanju minimalnih standarda za pružanje usluge dosezanja do mladih u kontekstu Garancije za mlade*, ISBN 9789220429600 (PDF);

Serbisht: *Смернице о одређивању минималних стандарда за пружање услуге досезања до младих у контексту Гаранције за младе*, ISBN 9789220429617 (PDF)

Emërtimet e përdorura në botimet dhe bazat e të dhënave të ILO-së, të cilat janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, si dhe paraqitja e materialit në to, nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë mendimi nga ana e ILO-së në lidhje me statusin juridik të ndonjë vendi, zone apo territori ose të autoriteteve të tij, apo në lidhje me përcaktimin e kufijve apo vijave kufitare. Shih: www.ilo.org/disclaimer.

Opinionet dhe qëndrimet e shprehura në këtë botim i përkasin autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet, qëndrimet apo politikat e ILO-së.

Përmendja e emrave të ndërmarrjeve, produkteve tregtare dhe proceseve nuk nënkupton miratimin e tyre nga ILO, dhe mos përmendja e ndonjë ndërmarrjeje, produkti tregtar apo procesi të caktuar nuk përbën shenjë mosmiratimi.

► **Udhëzues mbi përcaktimin e
standardeve minimale të ofrimit
të shërbimeve për kontaktimin
(outreach) e të rinjve në kontekstin
e Garancisë Rinore**

Përgatitur nga Valli Corbanese

Ky dokument është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European, në kuadër të Instrumentit të Asistencës Teknike EU-ILO për zbatimin e Garancisë për të Rinjtë në Ballkanin Perëndimor. Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij dokumenti i takon vetëm ILO-së. EU-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për saktësinë, korrektësinë ose besueshmërinë e ndonjë prej materialeve, informacioneve ose opinioneve të shprehura në këtë dokument.

► Tabela e përmbajtjes

► Tabela e përmbajtjes	4
► Hyrje.....	4
► SEKSIONI 1: Modeli i ndërhyrjes së kontaktimit.....	7
1. Identifikimi i të rinjve të paangazhuar (NEET).....	7
2. Kontaktimi	8
3. Angazhimi	9
4. Shërbimet mbështetëse të personalizuar	10
4.1. Referimi në Sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore	12
5. Monitorimi dhe përshtatja	12
► SEKSIONI 2: Nënkontraktimi i ndërhyrjeve të kontaktimit	14
6. Kriteret për nënkontraktim për aktivitetet e kontaktimit tek organizatat partnere	14
6.1. Kërkesat ligjore	14
6.2. Kërkesat operacionale	14
6.3. Kërkesat për ofrimin e shërbimeve.....	15
6.4. Kërkesat për monitorim.....	16
► Shtojca 1: Standardet minimale për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve të kontaktimit me të rinjtë.....	18
► Shtojca 2: Përgjegjësitë, kualifikimet dhe aftësitë e punëtorëve rinorë dhe të kontaktimit	25
Përgjegjësitë.....	25
Kualifikimet.....	26
Aftësitë	26


► Hyrje

Edhe pse nuk ka përkufizim të dakorduar në mënyrë unanime për “kontaktimin (outreach)” në kontekstin e politikave të punësimit të të rinjve, ky term kryesisht i referohet identifikimit, kontaktimit dhe angazhimit të të rinjve që: (i) janë të shkëputur nga tregu i punës dhe shoqëria (për shembull të rinjtë e papunë ose jashtë fuqisë punëtore për shkak të dekurajimit, aftësisë së kufizuar, përgjegjësisë të përkujdesjes ose arsyeve të tjera) dhe (ii) nuk janë të regjistruar për të marrë mbështetje nga asnjë ofrues publik i shërbimeve (punësim, shërbime sociale ose shëndetësore).¹

Në kontekstin e punësimit të të rinjve, kontaktimi përfshin: (i) fushata ndërgjegjësuere për t'i informuar të rinjtë e paangazhuar mbi shërbimet mbështetëse që janë në dispozicion; (ii) ndërhyrje për të identifikuar, kontaktuar dhe angazhuar të rinjtë që janë të shkëputur nga tregu i punës ose nga shoqëria; dhe (iii) ofrimin e shërbimeve të personalizuar të përfshirjes, afër vendbanimit (për shembull në komunitete lokale, shkolla, “one-stop-shops” ose përmes njësive të lëvizshme). Qëllimi është të sigurohet që të gjithë të rinjtë të kenë qasje të barabartë në shërbime dhe të ulen kostot individuale, ekonomike dhe shoqërore që lidhen me papunësinë kronike, përjashtimin social, përfshirjen në sistemin e drejtësisë dhe problemet afatgjata të shëndetit mendor.

Modeli i ndërhyrjes, i paraqitur në Figurën 1 përmbledh mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të qasjeve të kontaktimit në kuadër të *Veprimit Përgatitor për Garancinë Rinore Evropiane*, si dhe nga shqyrtimi i praktikave vendore që synojnë ofrimin e mbështetjes për të rinjtë e paangazhuar.²

► Figura 1. Fazat e modeleve të ndërhyrjes së kontaktimit



¹ Kuptimi këtij është se të rinjtë e regjistruar pranë ofruesve të shërbimeve (punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale) tashmë janë duke marrë mbështetje. Prandaj, përparësi duhet t'u jepet atyre që nuk po marrin ndihmë, edhe pse, në kuadër të ndërhyrjeve të kontaktimit, informacioni mbi regjistrimin e një të riu përfitues pranë një ofruesi shërbimesh zakonisht mblidhet gjatë ose pas fazës së angazhimit.

² Komisioni Evropian: *Pilotimi i partneriteteve të Garancisë Rinore në terren. Studim rasti: Strategji efektive të kontaktimit për të identifikuar dhe arritur tek NEET* (Bruksel, 2015); Komisioni Evropian: *Kontaktimi efektiv me NEET. Përvoja nga terreni*, Luksemburg, 2018.

Ky model përfshin katër faza, si dhe monitorimin dhe përshtatjen:

1. **Identifikimin.** Kjo fazë përcakton qasjet që do të përdoren për identifikimin e të rinjve të paangazhuar (për shembull, sistemet e gjurmimit, shkëmbimi dhe bashkimi (kombinimi) i të dhënave, marrëveshjet e partneritetit me organizatat rinore, rekrutimi i punëtorëve rinorë ose punëtorëve që merren me kontaktim).
2. **Kontaktimin.** Kjo fazë përcakton në detaje metodat që do të përdoren për t'i kontaktuar të rinjtë e paangazhuar (aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese, kontakt "një me një" përmes punës në terren, rrjetëzim me organizata të tjera) dhe identifikon subjektet ose individët përgjegjës për ofrimin e këtyre aktiviteteve (komunitet; punëtorët socialë; punëtorët rinorë, punëtorët e kontaktimit ose të terrenit; organizatat e shoqërisë civile).
3. **Angazhimin.** Kjo fazë përshkruan aktivitetet (argëtim, mësim joformal, këshillim dhe orientim) që duhet të zbatohen për t'i angazhuar të rinjtë e shkëputur nga tregu dhe për t'i orientuar ata drejt shërbimeve që janë në dispozicion për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.
4. **Ofrimin e shërbimeve.** Kjo fazë përcakton kombinimin dhe renditjen e shërbimeve që do t'u ofrohen të rinjve të paangazhuar (vlerësim individual, këshillim zhvillues (coaching), trajnim motivues, trajnim për vetëdije dhe vetëvlerësim, aftësi komunikimi, punë në ekip, aftësi përgatitore për punë, përvoja praktike në punë, mentorim individual dhe referim te shërbime të specializuara). Po ashtu në këtë fazë planifikohet mënyra se si i gjithë sistemi mbështetës do të funksionojë në praktikë; dhe përcakton në detaje përgjegjësitë specifike të aktorëve të përfshirë në kontaktim (kush do të bëjë çfarë).

Monitorimi dhe përshtatja i referohen sistemit të monitorimit që do të përdoret për të vlerësuar progresin individual dhe zbatimin e aktiviteteve, si dhe mënyrën se si gjetjet do të shfrytëzohen për të përshtatur ofrimin e aktiviteteve të kontaktimit dhe angazhimit dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.

Qëllimi i këtij udhëzuesi teknik është të ofrojë këshilla për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të angazhuara në zbatimin e Garancisë Rinore të Përfortuar mbi:

- (i) projektimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të kontaktimit të organizuara në partneritet me organizatat e shoqërisë civile (OSHC);³
- (ii) zhvillimin e standardeve minimale të cilësisë për ofrimin e ndërhyrjeve të kontaktimit, të përshtatura sipas rrethanave kombëtare dhe lokale; dhe
- (iii) vendosjen e kërkesave për jashtëkontraktim (dhënie të shërbimeve tek palët e treta) dhe kontraktim ndërmjet institucioneve përgjegjëse për kontaktim dhe OSHC-ve.

Ndërhyrjet e kontaktimit të paraqitura më poshtë nuk përfshijnë aktivitetet parandaluese që zhvillohen me të rinjtë që ende janë pjesë e sistemit formal të arsimit dhe trajnimit (për të shmangur braktisjen e hershme të shkollës), pasi shumica e planeve të zbatimit të Garancisë Rinore i trajtojnë këto si pjesë të "aktiviteteve të ndërhyrjes së hershme" të menaxhuara nga ministritë e arsimit.

Hartimi i një modeli të ndërhyrjeve për kontaktim në nivel kombëtar duhet të paraprihet nga një hulumtim mbi karakteristikat kryesore të të rinjve të paangazhuar dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, si dhe mbi burimet në dispozicion (hartëzimi i burimeve).

Mjeti kryesor për të kuptuar karakteristikat dhe shpërndarjen gjeografike të të rinjve të paangazhuar është profili statistikor i të rinjve (15–29 vjeç) që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET). Ky hulumtim përdor të dhënat mikro të Anketës Kombëtare të Fuqisë Punëtore për të: (i) kategorizuar të rinjtë NEET në nëngrupe të ndryshme sipas statusit të tyre në tregun e punës (të papunë afatshkurtër dhe afatgjatë, një pjesë e të cilëve janë të regjistruar në Shërbimin Publik të Punësimi; të rinjtë jashtë fuqisë punëtore për shkak të sëmundjes/aftësisë së kufizuar, përgjegjësitë të përkujdesjes, dekurajimit apo arsyeve të tjera); (ii) mbledhur informacion shtesë mbi karakteristikat

³ Të gjitha planet e zbatimit të Garancisë Rinore në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor mbështeten në partneritete me organizatat e shoqërisë civile për të kontaktuar të rinjtë e paangazhuar të moshës 15–29 vjeçare.

individuale të të rinjve NEET që i përkasin grupeve të ndryshme (mosha, gjinia, niveli i arsimit); (iii) hartuar shpërndarjen e tyre rajonale; dhe (iv) kuptuar faktorët që përcaktojnë më së shumti probabilitetin për t'u bërë NEET. Ky hulumtim informon hartimin e një strategjie kontaktimi të bazuar në evidenca (çështjet kryesore që duhet adresuar, grupet e synuara, shpërndarja e burimeve).

Ushtrimi i dytë hulumtues është hartëzimi i burimeve, i cili përfshin: (i) identifikimin dhe dokumentimin e burimeve në dispozicion për të rinjtë në nivel komuniteti (asetet fizike, llojet e shërbimeve, personeli); dhe (ii) identifikimin e burimeve të reja ose shtesë që nevojiten për të adresuar nevojat. Në kontekstin e planifikimit të aktiviteteve të kontaktimit, hartëzimi i burimeve mund të shërbejë gjithashtu për të identifikuar organizata partnere potenciale dhe kapacitetin e tyre për të kryer punë rinore të kontaktimit.

Gjetjet nga këto ushtrime të përmirësimit të njohurive mund të përdoren për të përcaktuar fushën e aktiviteteve të kontaktimit rinor (grupet e synuara, vendndodhjet me prioritet); për të dizajnuar fazat e ndryshme të modelit të ndërhyrjes së kontaktimit; dhe për të përcaktuar elementet thelbësore për jashtëkontraktimin/kontraktimin e organizatave partnere të kontaktimit.

► SEKSIONI 1: Modeli i ndërhyrjes së kontaktimit

1. Identifikimi i të rinjve të paangazhuar (NEET)

Sistemet për identifikimin e të rinjve të paangazhuar dhe vendosjen e kontaktit të parë me ta zakonisht mbështeten në tre metoda kryesore, të cilat shpesh kombinohen: (i) sistemet e gjurmimit dhe bashkimi i të dhënave administrative; (ii) partneriteti me organizata që u shërbejnë nevojave të të rinjve; dhe (iii) rekrutimi i punëtorëve të kontaktimit ose punëtorëve rinorë për të kryer punë në terren.

Qasjet e gjurmimit dhe shkëmbimit të të dhënave shërbejnë për të “ndjekur gjurmët” e të rinjve të paangazhuar (që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim) me synimin për të vendosur kontaktin e parë dhe për t’u ofruar mbështetje. Sistemet e gjurmimit zakonisht lidhin sistemin e informacionit arsimor, i cili regjistron të dhënat mbi rezultatet e nxënësve dhe studentëve, me baza të tjera administrative (për shembull shërbimet publike të punësimit, shërbimeve sociale ose regjistrat e komunave) për të monitoruar kalimin nga shkolla në punë dhe për të “gjurmuar” të rinjtë që braktisin shkollën dhe kanë humbur nga radarët institucional. Në varësi të kontekstit kombëtar, detyra e gjurmimit të të rinjve mund të kryhet nga institucione të ndryshme si shkollat (ose organet e lidhura me autoritetet arsimore), Shërbimi Publik i Punësimit (ShPP), shërbimet sociale ose komunat. Qëllimi është të identifikohen të rinjtë që nuk janë të regjistruar në asnjë agjenci mbështetëse, të kontaktohen dhe të angazhohen (në arsim, punësim ose shoqëri). Sistemet e gjurmimit dhe bashkimit të të dhënave kërkojnë që të dhënat personale të ndahen mes institucioneve, gjë që në disa vende nuk është e mundur pasi legjislacioni mbi privatësinë e të dhënave dhe kufizimeve të ndërveprueshmërisë së sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT) të institucioneve publike.

Qasja e dytë e përdorur për të identifikuar të rinjtë e paangazhuar është rekrutimi i drejtpërdrejtë punëtorëve rinorë ose i punëtorëve të kontaktimit për të kryer punë në terren. Në këtë rast, institucioni publik përgjegjës për zbatimin e strategjisë së kontaktimit (qendrat rinore, Ministrinë përgjegjëse për çështjet e rinisë, komunat ose Shërbimi Publik i Punësimit) rekruton staf shtesë (punëtor rinorë dhe punëtor të kontaktimit) për të identifikuar, kontaktuar dhe angazhuar të rinjtë përmes punës në rrugë/terren (angazhimi me individë në hapësira publike si rrugë, parqe, qendra tregtare, shkolla, për të ofruar mbështetje).

Qasja e fundit e përdorur për të identifikuar të rinjtë e paangazhuar është mbështetja në aktivitetet e organizatave që u shërbejnë nevojave të të rinjve. Këto organizata mund të jenë subjekte publike ose gjysmëpublike (për shembull qendrat rinore) ose, më shpesh, organizata rinore të shoqërisë civile. Aktivitetet që zhvillohen rregullisht nga këto organizata (sport, argëtim, mësim joformal) u mundësojnë stafit të tyre të vendosin kontakte me kategori të ndryshme të të rinjve, përfshirë edhe ata të paangazhuar. Ky informacion shfrytëzohet nga institucionet publike përgjegjëse për zbatimin e strategjisë kombëtare të kontaktimit përmes partneriteteve ose jashtëkontraktimit (pra, organizatat partnere kontraktohen për të identifikuar, kontaktuar dhe angazhuar të rinjtë e paangazhuar dhe për t’i ndihmuar ata të afrohen me shërbimet e punësimit, shërbimet sociale ose shëndetësore që janë në dispozicion).

Meqenëse aktualisht sistemet e gjurmimit dhe rekrutimi i drejtpërdrejtë i punëtorëve rinor apo të kontaktimit janë të limituara në ekonominë e Ballkanit Perëndimor (për shembull, për shkak të kufizimeve në ndërveprueshmërinë e të dhënave, ligjeve strikte mbi privatësinë e të dhënave dhe mungesës së burimeve financiare për rekrutim të drejtpërdrejtë), të gjitha planet e zbatimit të Garancisë Rinore mbështeten te organizatat rinore të shoqërisë civile për të planifikuar dhe zbatuar fazat e ndryshme të procesit të kontaktimit (identifikimi, kontaktimi dhe angazhimi, ofrimi i shërbimeve mbështetëse). Kjo do të thotë se, në rastin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, fazat e identifikimit dhe kontaktimit të modelit të ndërhyrjes për kontaktim janë të kombinuara.

► Kutia 1: Punëtori i kontaktimit dhe punëtori rinorë

Punëtori i kontaktimit është një profesionist (kërkohet diplomë bachelor në punë sociale, psikologji, sociologji ose në një fushë të ngjashme) që angazhohet me individë dhe komunitete, shpesh në zona të vështira për t'u arritur, për të ofruar mbështetje, burime dhe orientim. Këta profesionistë punojnë për të ndërtuar ura lidhëse mes individëve që kanë nevojë për ndihmë dhe shërbimeve të disponueshme, duke i ndihmuar ata të tejkalojnë pengesat dhe të përmirësojnë mirëqenien e tyre të përgjithshme. Punëtorët e kontaktimit punojnë me persona të pastrehë, individë me varësi ose probleme të shëndetit mendor, persona me aftësi të kufizuara ose në konflikt me ligjin.

Punëtori rinor (kodi ESCO 2635) mbështet zhvillimin personal, social dhe arsimor të të rinjve përmes aktiviteteve dhe marrëdhënieve joformale. Ata i fuqizojnë të rinjtë që të marrin vendime pozitive për jetën e tyre, duke punuar shpesh në mjedise të arsimit joformal si qendra rinore, organizata komunitare dhe shkolla. Punëtorët rinorë krijojnë mundësi për të rritur mësimnxënien dhe zhvilluar aftësitë përmes aktiviteteve dhe programeve të ndryshme. Ata lidhin të rinjtë me shërbimet përkatëse, mbështesin rrjetet dhe mundësitë brenda komunitetit, duke adresuar shpesh çështje si varfëria, diskriminimi dhe përjashtimi social. Disa vende (për shembull Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Italia) ofrojnë programe universitare dhe pasuniversitare në fushën e punës rinore dhe punës komunitare.

Puna rinore e kontaktimit është një formë e punës rinore që synon të arrijë tek të rinjtë që kanë nevojë për ndihmë brenda komunitetit të tyre dhe t'u sigurojë qasje në shërbime dhe mbështetje të tjera, të destinuara për të nxitur zhvillimin e tyre, pavarësinë, përfshirjen sociale dhe aftësitë për menaxhimin e jetës, si dhe për të përmirësuar qasjen e tyre në arsim dhe në tregun e punës.

Burimi: Përfundimet e Këshillit mbi kontributin e punës cilësore me të rinjtë për zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen sociale të të rinjve (2013/C 168/03); E. Pammi et al (eds), *Manuali i Punës Rinore të Kontaktimit - The Finnish Way*, Into – Shoqata për Punën Rinore të Kontaktimit dhe Aktivitetet e Punëtorëve, 2022.

2. Kontaktimi

Kontakti i parë me të rinjtë e paangazhuar realizohet, përmes disa mënyrave të ndryshme, nga stafi (punëtorët rinorë ose punëtorët e kontaktimit) i organizatave partnere të ngarkuara me zbatimin e aktiviteteve të kontaktimit. Qëllimi është përfshirja e sa më shumë të rinjve në aktivitetet e organizatës partnere, me synim identifikimin dhe mbështetjen e atyre më së shumti të shkëputur nga tregu. Parakushtet kryesore që kjo të funksionojë janë: aktivitetet të jenë lehtësisht të qasshme (me prag të ulët hyrjeje) dhe tërheqëse (për shembull aktivitete argëtuese, artistike ose sportive); organizata të njihet si e besueshme dhe “e aftë për të ndihmuar”; dhe qasja e përdorur të jetë pa paragjykimë, mendjehapur dhe e bazuar në pjesëmarrje vullnetare dhe konfidencialitet.

Organizatave rinore partnere në ekonominë e Ballkanit Perëndimor duhet t'u kërkohet të përdorin kanale të shumta për të kontaktuar të rinjtë që i përkasin nëngrupeve të ndryshme të NEET, siç identifikohen në nivel kombëtar/lokal përmes hartëzimit statistikor të NEET. Për shembull, të rinjtë e papunë me aftësi të mesme ose të larta mund t'i përgjigjen pozitivisht fushatave ndërgjegjësuuese të zhvilluara përmes rrjeteve sociale. Këto kategori të të rinjve kanë më shumë gjasa të ndërmarrin veprime vetë, nëse dinë se ku mund të marrin informacion dhe mbështetje. Ndërsa të rinjtë e margjinalizuar kanë më shumë gjasa të përgjigjen ndaj kontakteve “një me një” (online ose ballë për ballë) të realizuara nga punëtorët rinorë të kontaktimit. Të rinjtë që janë edhe më larg tregut të punës dhe shoqërisë, ose që përballen me shumë disavantazhe, kanë nevojë për më shumë kohë për t'u angazhuar dhe gjithashtu mund të kenë nevojë për mentorim “një me një” gjatë gjithë rrugëtimit të tyre. Prandaj, organizatat partnere të kontaktimit duhet të kontaktojnë të rinjtë e paangazhuar përmes një kombinimi të mënyrave të mëposhtme:

- **Aktivitetet informuese dhe ndërgjegjëse:** Këto metoda janë të dobishme për të kontaktuar dhe informuar kategori të ndryshme të të rinjve (ata që kanë braktisur shkollën, të papunët e paregjistruar, të rinjtë me nivele të ndryshme të aftësive). Aktivitetet informuese dhe ndërgjegjëse duhet të përdorin mjete të ndryshme të komunikimit, si materiale të shtypura dhe digjitale, rrjete sociale, linja telefonike ndihmëse dhe numra pa pagesë. Informacioni i dhënë përmes këtyre kanaleve duhet të jetë i dobishëm, i lehtë për t'u kuptuar dhe të ofrojë, si hap vijues, një hapësirë fizike ku të rinjtë mund të kenë qasje në aktivitete me prag të ulët të angazhimit (argëtim, mësim joformal, këshilla mes bashkëmoshatarëve).
- **Kontakti një me një:** Edhe pse kërkon më shumë burime, kjo metodë përfaqëson mënyrën më efektive për të kontaktuar (dhe mundësisht për të angazhuar) të rinjtë e shkëputur nga tregu. Ajo duhet të realizohet nga punëtorët e kontaktimit, të trajnuar në mënyrë adekuate për të komunikuar me të rinjtë, për të ndërtuar marrëdhënie besimi dhe për të ofruar informacion dhe këshilla kur dhe nëse nevojitet. Aktivitetet për të kontaktuar të rinjtë e shkëputur nga tregu zakonisht zhvillohen në zona ku dihet se ata mbledhen, qoftë fizikisht (qendra tregtare, qendra komunitare, dyqane lojërash, salla koncertesh dhe sportive) ose online (platforma si TikTok, Facebook, Instagram, LinkedIn). Ideja është të krijohet një raport besimi, të jepet informacion dhe të ofrohet mundësia e një hapësire miqësore për të rinjtë ku ata mund të shkojnë dhe të "kalojnë kohë".
- **Rrjetëzimi me ofrues të tjerë të shërbimeve:** Rrjetëzimi me ofrues të tjerë të shërbimeve (publik ose privat), si shkollat, qendrat shëndetësore dhe të punës sociale, ose organizatat e tjera të shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal, ofron një mënyrë për t'u lidhur (drejtpërdrejt ose tërthorazi) me të rinjtë e shkëputur nga tregu. Rrjetëzimi me ofrues të tjerë të shërbimeve funksionon në dy drejtime: (i) është mjet për organizatat e kontaktimit që të mbledhin informacion për të rinjtë e shkëputur nga tregu që duhen kontaktuar dhe angazhuar; dhe (ii) mund të përdoret nga organizatat partnere për të referuar për ndihmë ata që kanë nevojë për mbështetje të specializuar (shërbime arsimore dhe shëndetësore, mbështetje materiale, strehim, etj.).

Treguesit e monitorimit që mund të merren parasysh për të matur efektivitetin e aktiviteteve të kontaktit janë: (i) numri total i të rinjve të kontaktuar përmes aktiviteteve të "kontaktit" (i ndarë sipas llojit të aktivitetit, si për shembull fushata në rrjete sociale, aktivitete në terren); dhe (ii) numri total i të rinjve të kontaktuar përmes mënyrave të ndryshme, të cilët kanë kaluar në fazën e "angazhimit". Për të matur saktë këta tregues, është e nevojshme që organizatat e kontaktimit të mbajnë dëshmi për aktivitetet e "kontaktit" të organizuara dhe për numrin e përafërt të të rinjve të arritur në secilin aktivitet. Për shembull, për një aktivitet ndërgjegjëses të organizuar përmes një dëshmie në TikTok, treguesi do t'i referohet numrit të të rinjve që e kanë parë videon brenda një periudhe të caktuar kohore.

Për qëllime të jashtëkontraktimit, autoritetet kontraktuese mund të vendosin një numër minimal të aktiviteteve ndërgjegjëse (çdo tremujor ose vit), si dhe një frekuencë minimale të punës në terren në komunitetet lokale.

3. Angazhimi

Angazhimi ndodh kur një i ri, i kontaktuar përmes punës së kontaktimit, vendos të marrë pjesë në një nga aktivitetet me prag të ulët të ofruara nga organizatat partnere (metoda e punës rinore të hapur).⁴ Mund të kërkojë kohë dhe disa kontakte derisa një i ri të jetë gati t'u besojë punëtorëve rinorë të kontaktimit dhe të fillojë të angazhohet. Momenti që sinjalizon angazhimin e të rinjve në procesin e kontaktimit është pjesëmarrja e tyre në një ose më shumë nga aktivitetet me prag të ulët që ofrohen (argëtim, lojëra sportive, arte skenike, punëtori, aktivitete të tjera) dhe/ose komunikimi me stafin e kontaktimit dhe me bashkëmoshatarët. Në këtë fazë, të rinjtë mund të japin vullnetarisht të dhënat e tyre personale (bazike) (emrin, numrin e telefonit, llogarinë në rrjete sociale), ose mund të vendosin të mbeten anonimë. Dorëzimi i të dhënave personale mund të shtyhet deri në momentin kur ata marrin

⁴ Puna rinore e hapur fokusohet në ofrimin e mundësive të arritshme dhe vullnetare për të rinjtë që të angazhohen në aktivitete shoqërore, arsimore dhe rekreative brenda komuniteteve të tyre. Ajo thekson krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në të cilat të rinjtë mund të zhvillojnë aftësi, të marrin pjesë në veprime shoqërore dhe të eksplorojnë interesat e tyre. Puna rinore e hapur shpesh realizohet përmes qendrave rinore dhe organizatave të tjera të bazuara në komunitet.

mbështetje të personalizuar (për shembull nëse një i ri dëshiron të marrë pjesë në një seancë këshillimi për karrierën në grup, ose në një punëtori mësimore, kërkohet të paraqesë një dokument identifikimi që shërben për ta gjurmuar gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve).

Angazhimi zakonisht kërkon një hapësirë fizike në të mund të organizohen aktivitetet me prag të ulët dhe të tjera aktivitete angazhuese (mund të jenë ambientet e organizatës partnere, të qendrave rinore, ose hapësira të tjera të vëna në dispozicion nga komuna apo organizata të tjera të rrjetit). Angazhimi online mund të funksionojë fillimisht, por në fund kërkohet prania fizike dhe pjesëmarrja për të avancuar në aktivitetet e zhvillimit personal (ndërveprimi me të rritur dhe bashkëmoshatarë, ndërtimi i vetëbesimit, krijimi i marrëdhënieve).

Aktivitetet e angazhimit me prag të ulët mund të përfshijnë sporte në ekip (volejboll, futboll, basketboll); lojëra (lojëra tavoline, lojëra shahu, video lojëra), arte (teatër, muzikë, fotografi, grafiti); aktivitete të tjera argëtuese (vallëzim, filma, kampe). Aktivitetet e angazhimit të plotë përfshijnë punëtori të arsimit joformal (aftësi digjitale, të folur në publik, çështje shëndetësore, aftësi për jetën) dhe vullnetarizëm në komunitet.

Treguesit e monitorimit për aktivitetet e angazhimit të përmendura më sipër mund të përqendrohen tek: (i) numri i të rinjve që u angazhuan në aktivitetet e disponueshme me prag të ulët (sipas grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aktivitetit); (ii) numri i të rinjve që marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e angazhimit; (iii) numri i të rinjve që avancojnë drejt shërbimeve mbështetëse të personalizuar (sipas grupmoshës dhe gjinisë); dhe (iv) numri i të rinjve që regjistrohen në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore (ose që angazhohen ndryshe në punësim, arsim të mëtejshëm, trajnim apo praktikë profesionale).⁵ Për qëllime të ofrimit të shërbimeve dhe monitorimit, organizata e kontaktimit duhet të zhvillojë një formular elektronik regjistrimi ku regjistrohen dhe ruhen të dhënat e përfutuesve. Ky formular “bazik” regjistrimi do të plotësohet më tej me informacion shtesë gjatë zhvillimit të mbështetjes së personalizuar.

Për qëllime të jashtëkontraktimit, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë një numër minimal aktiviteteve me prag të ulët dhe aktiviteteve të mirëfillta angazhimi që organizatat partnere duhet të ofrojnë (në baza javore, mujore), si edhe hartimin e një kornize monitorimi për të matur përparimin e individëve nga angazhimi me prag të ulët deri te vlerësimi i gatishmërisë për të marrë pjesë në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore.

4. Shërbimet mbështetëse të personalizuar

Shërbimet mbështetëse për të rinjtë e shkëputur nga tregu i punës që ofrohen nga organizatat partnere duhet të jenë: (i) të përshtatura me karakteristikat individuale dhe barrierat specifike që duhen adresuar; dhe (ii) të organizuara përgjatë një zinxhiri të vazhdueshëm asistence që e shoqëron të riun nga kontakti i parë deri në përfshirjen në punësim, arsim ose trajnim.

Pako e asistencës e ofruar nga organizatat e kontaktimit mund të përfshijë: (i) vlerësim të personalizuar të nevojave (për të identifikuar barrierat individuale dhe për të hartëzuar kërkesat për shërbime); (ii) informim, këshillim dhe orientim (mbi të gjitha aspektet e jetës së të riut); (iii) shërbime për rritjen e motivimit, vetëvlerësimin dhe vetëdijes; (iv) trajnim mbi aftësitë bazë të punësueshmërisë (komunikimi, puna në grup, menaxhimi i kohës, mendimi kritik); dhe (v) referim (dhe shoqërim) te shërbimet e specializuara (arsim dhe trajnim, punësim, shërbime shëndetësore, shërbime sociale).

Vlerësimi i personalizuar (ose profilizimi) është një mjet i orientuar për të mbledhur informacion dhe për të identifikuar sfidat dhe nevojat e individit në dimensionet e ndryshme të jetës (arsim, familje, punësim ose shëndet). Ky proces mbështetet në këshillim, teknika ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe teknika të punës rinore, dhe përbën bazën për planifikimin e ofrimit të shërbimeve. Vlerësimi është gjithashtu thelbësor për të kuptuar nëse gama e shërbimeve të ofruara nga organizata e kontaktimit është e mjaftueshme për të adresuar nevojat individuale apo nëse kërkohet ndërhyrja e profesionistëve/agjencive të tjera. Ky aktivitet kërkon nga organizata e kontaktimit të zhvillojë një pyetësor të strukturuar për të identifikuar dhe regjistruar saktësisht sfidën kryesore me të cilën përballet i riu në

⁵ Është e mundur që disa të rinj të kenë nevojë për një minimum mbështetjeje për t'u ri-angazhuar në tregun e punës dhe në shoqëri.

dimensionet e jetës së tij/saj (arsim, familje, shëndet, punësim). Ky mjet do të shërbejë gjithashtu si bazë për planifikimin e veprimeve dhe ofrimit të shërbimeve.

Mbështetja e personalizuar ofrohet kryesisht përmes këshillimit zhvillues (coaching), mentorimit, këshillimit dhe orientimit gjatë gjithë procesit të përfshirjes. Këto aktivitete zakonisht realizohen nga punëtorët e kontaktimit ose punëtorët rinorë që kanë vendosur kontaktin fillestar dhe kanë ndërtuar marrëdhënie besimi (angazhim) me të rinjtë e shkëputur nga tregu. Tipologjia e shërbimeve mbështetëse të ofruara për të rinjtë e paangazhuar mund të ndahet në dy kategori kryesore, të cilat zakonisht ofrohen në faza të ndryshme të procesit të përfshirjes.

Kategoria e parë përfshin shërbimet që synojnë **përmirësimin e vetëdijes, motivimit dhe aftësive për jetën të individit**. Qëllimi është të “përgatitet dhe motivohet” i riu për të pasur qasje në shërbime më intensive dhe të orientuara drejt qëllimeve. Kjo kategori e parë shërbimesh duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të ofrohet brenda vetë organizatës partnere të kontaktimit.

- Trajnim dhe këshillim zhvillues (coaching) mbi aftësitë jetësore: Menaxhimi i emocioneve dhe zemërimit, zgjidhja e problemeve, marrja e vendimeve, vendosja e qëllimeve, shëndeti dhe mirëqenia (përfshirë shëndetin seksual), vetëkuptimi, identiteti social, empatia, marrëdhëniet, aftësitë e socializimit. Këto sesione, si në grup ashtu edhe individuale, duhet të ofrohen nga staf i trajnuar siç duhet (shih Shtojcën 2 për përgjegjësitë, kualifikimet dhe kompetencat e punonjësve të kontaktimit/rinorë). Këto kanë për qëllim të ndihmojnë të rinjtë të menaxhojnë sfidat në një ose më shumë dimensione të jetës.
- Informim dhe këshillim mbi karrierën (bazik): Këto aktivitete, që ofrohen individualisht ose në grup, ballë për ballë ose online, kanë për qëllim t’u ndihmojnë të rinjve të marrin vendime të informuara për arsimimin, trajnimin ose punësimin.
- Aftësi për botën e punës (trajnim ose këshillim zhvillues (coaching)): Komunikimi, puna në ekip, aftësitë përgatitore për punë. Këto shërbime kanë për qëllim të rrisin aftësitë e punësueshmërisë tek të rinjtë. Ato mund të ofrohen përmes seancave individuale ose në grup të udhëhequra nga staf i trajnuar siç duhet. Trajnimi/këshillimi zhvillues (coaching) për aftësitë përgatitore për punë, më konkretisht, synon t’i pajisë të rinjtë me aftësi për përpilimin e CV-së që përputhen me shpalljet e vendeve të punës, zhvillimin e një interviste pune dhe përdorimin e kanaleve të ndryshme për kërkimin e punës (rrjete personale, internet, kontakt i drejtpërdrejtë me punëdhënësit).
- Përvoja provuese në punë (work tasters) (opsionale): Këto janë periudha të shkurtra të mësimnxënies të organizuara në një shkollë profesionale ose qendër trajnimi, ku të rinjtë kryejnë detyrat e një pune me synimin për të zgjedhur profesionin që u përshtatet më së miri aspiratave dhe nevojave të tyre. Ky është një mjet që zakonisht përdoret në këshillimin për karrierën për të ndihmuar të rinjtë të marrin vendime të informuara. Organizimi i përvojave provuese në punë kërkon që organizatat partnere të krijojnë rrjetëzim me institucionet e arsimit dhe trajnimit për të rritur.

Secila linjë shërbimi që do të ofrohet nga organizata e kontaktimit duhet të përshkruhet qartë (qëllimet, përmbajtja që do të ofrohet, kohëzgjatja e vlerësuar, numri dhe kualifikimet e stafit të angazhuar në ofrimin e shërbimit) dhe rezultatet për secilin përfitues individual të regjistruar. Është praktikë e mirë që, pasi një i ri të jetë profilizuar, të bihet dakord me të për një rrugë shërbimi që do të ndiqet (plan shërbimi individual, i ndërmarrë mbi bazë vullnetare). Kjo gjithashtu mund t’i shërbejë organizatave të kontaktimit si mjet për të vlerësuar përparimin e të riut gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimeve dhe për të ndihmuar në përcaktimin e momentit kur ai/ajo është gati të referohet në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore.

Kategoria e dytë e mbështetjes përfshin **shërbimet e specializuara** – që zakonisht ofrohen nga ofrues të ndryshëm publik ose privat. Këto përfshijnë shërbime shëndetësore (sëmundje, aftësi të kufizuara, shëndet mendor, varësi, fertilitet dhe kontracepsion), shërbime të ofruara nga qendrat e punës sociale (strehim, varfëri, kujdes për fëmijë ose të moshuar, transport) dhe shërbime të tjera të specializuara (për shembull programe rehabilitimi për varësitë, shërbime për viktimat e dhunës në familje, trafikimit apo shfrytëzimit në punë). Zakonisht qasja në këto shërbime sigurohet nga organizata partnere përmes referimit (pra, i riu shoqërohet tek një ofrues shërbimi që është pjesë e rrjetit të organizatës për asistencë të specializuar). Shtrirja e rrjetit të referimit është kriter kyç në procesin e përzgjedhjes së organizatave partnere të kontaktimit.

Treguesit kryesorë të monitorimit për këtë fazë të kontaktimit janë: (i) numri i të rinjve që marrin vlerësim të personalizuar të nevojave (sipas grupmoshës dhe gjinisë); (ii) numri i përfituesve të shërbimeve të përfshirjes (sipas llojit të shërbimit dhe kohëzgjatjes, si dhe sipas gjinisë dhe grupmoshës); (iii) numri i përfituesve që referohen tek një ofrues i jashtëm shërbimesh për mbështetje (sipas llojit të shërbimit të kërkuar, gjinisë dhe grupmoshës); (iv) numri i përfituesve të shërbimeve (të brendshme dhe të jashtme) që referohen në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore.

4.1. Referimi në Sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore

Qëllimi përfundimtar i shërbimeve të kontaktimit, nën kuadrin e politikës së Garancisë Rinore, është të motivojë dhe përgatisë të rinjtë e shkëputur nga tregu i punës për të marrë mbështetje më intensive dhe të orientuar drejt objektivave, me synim rikthimin në arsim/trajnim ose hyrjen në tregun e punës.

Referimi në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore do të bëhet kur i riu ka përfunduar rrugëtimin e tij/saj të shërbimeve në organizatën partnere dhe konsiderohet (si nga punëtori i kontaktimit ashtu edhe nga vetë i riu) si “gati” për t’u regjistruar si përfitues i Garancisë Rinore në zyrën lokale të Shërbimit Publik të Punësimit (ShPP). Një përmbledhje e shërbimeve ku ka marrë pjesë i riu në organizatën e kontaktimit do t’i përcillet stafit të ShPP-it që merret me regjistrimin, profilizimin dhe këshillimin në kuadër të Garancisë Rinore (për të shmangur dyfishimin e asistencës). Nëse sistemi i regjistrimit të Garancisë Rinore menaxhohet online, punëtori i kontaktimit do ta ndihmojë të riun të regjistrohet dhe do të sigurojë që ai/ajo të marrë pjesë në intervistën e parë këshilluese.

Për këtë fazë të fundit të kontaktimit ekziston vetëm një tregues, përkatësisht numri i përfituesve të shërbimeve të kontaktimit që regjistrohen në Garancinë Rinore (sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor), pasi nga momenti i regjistrimit në Garancinë Rinore zbatohet një kornizë tjetër monitorimi. Nëse mbështetja përmes mentorimit zgjatet nga organizata partnere gjatë periudhës së ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore (për të minimizuar braktisjen), treguesit e monitorimit duhet të përfshijnë numrin e përfituesve të kontaktimit të regjistruar në Garancinë Rinore dhe që marrin mentorim nga organizata partnere (sipas gjinisë dhe moshës, kohëzgjatjes së mentorimit në javë/muaj).

5. Monitorimi dhe përshtatja

Monitorimi dhe përshtatja e modelit të kontaktimit janë thelbësore për të siguruar efektivitetin dhe reagimin e tij ndaj nevojave të të rinjve të paangazhuar. Monitorimi përfshinë: (i) mbledhjen e të dhënave dhe informacionit mbi aktivitetet e kontaktimit të zhvilluara dhe progresin e përfituesve individualë përgjatë fazave të kontaktimit (shih gjithashtu paragrafin 5.4); dhe (ii) analizën e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të secilës prej fazave të modelit të kontaktimit. Udhëzime mbi llojin e të dhënave dhe informacionit që duhet të mblidhen gjatë zbatimit janë dhënë tashmë në përshkrimin e katër fazave të modelit të kontaktimit të paraqitura në paragrafët e mëparshëm.

Të dhënat e monitorimit (mbi zbatimin e të gjitha aktiviteteve, nga kontakti deri te ofrimi i shërbimeve, si dhe mbi progresin individual të përfituesve) duhet të analizohen për të identifikuar prirjet, devijimet nga rezultatet e pritura, pengesat dhe boshllëqet, si edhe rastet e pasojave të paqëllimshme (Kutia 2 ofron disa pyetje udhëzuese për analizën e të dhënave).

► Kutia 2: Pyetje udhëzuese për të analizuar të dhënat e monitorimit të kontaktimit

Kontakti dhe angazhimi

- Cila metodë e kontaktimit duket se funksionon më mirë (ndërgjegjësimi, kontakti një me një, rrjetet sociale) dhe për cilat grupe të të rinjve (sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të aftësive)?
- Cilat grupe të të rinjve janë të nën- ose të mbi- përfaqësuar në aktivitetet e kontaktit?
- Cilat grupe të të rinjve po përparojnë më shpejt/ngadalë drejt aktiviteteve të angazhimit?
- A janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion për të arritur objektivat e përcaktuara?
- Cili aktivitet angazhimi duket se funksionon më mirë (sportet, artet, argëtimi) dhe për cilat grupe të të rinjve (sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të aftësive)?
- Cilat grupe të të rinjve janë të nën- ose të mbi-përfaqësuar në aktivitetet e angazhimit?
- Cilat grupe të të rinjve po përparojnë më shpejt/ngadalë drejt ofrimit të shërbimeve?
- A janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion për të arritur objektivat e përcaktuara për angazhimin?
- Çfarë sugjerojnë përfituesit në lidhje me aktivitetet e angazhimit? A ka sugjerime që mund të merren parasysh?

Ofrimi i shërbimeve

- Cilat shërbime përdoren më shumë/më pak?
- Cilat grupe të të rinjve (sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të aftësive) kanë më shumë gjasa të referohen te secili shërbim?
- Cila është kohëzgjatja mesatare e secilit shërbim të ofruar për përfituesit?
- Cili është niveli i braktisjes nga secili shërbim? Cilat janë arsyet kryesore të braktisjes?
- Cilat grupe të të rinjve janë të nën- ose të mbi-përfaqësuar në ofrimin e shërbimeve?
- Cilat grupe të të rinjve po përparojnë më shpejt/ngadalë drejt Garancisë Rinore?
- A janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion për secilin shërbim për të arritur objektivat e përcaktuara?
- Cili shërbim duhet të zgjerohet/reduktohet?
- Çfarë sugjerojnë përfituesit në lidhje me shërbimet? A ka sugjerime që mund të merren parasysh?

Pasi të jenë identifikuar boshllëqet, do të jetë e mundur të përshtaten aktivitetet e modelit të kontaktimit në lidhje me grupet e synuara, kanalet e përdorura, shpeshësinë dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve, përmbajtjen e shërbimeve dhe nevojat për burime.

► SEKSIONI 2: Nënkontraktimi i ndërhyrjeve të kontaktimit

6. Kriteret për nënkontraktim për aktivitetet e kontaktimit tek organizatat partnere

Ky seksion paraqet kriteret bazë që duhen marrë parasysh për të kontraktuar organizatat rinore të shoqërisë civile për zbatimin e aktiviteteve të kontaktimit, të cilat duhet të përshtaten me legjislacionin ekzistues mbi prokurimin dhe me rrethanat lokale të ekonomive të Ballkanit Perëndimor.

Para se të realizohet jashtëkontraktimi i aktiviteteve të kontaktimit gjatë fazës së pilotimit të Garancisë Rinore të Përfortuar, rekomandohet të zhvillohet një hartëzim i burimeve për të identifikuar dhe vlerësuar shërbimet, programet, organizatat dhe burimet e tjera që ekzistojnë në një vend specifik. Ky hartëzim burimesh do të shërbejë për disa qëllime: (i) mundëson ndërtimin e ndërhyrjeve të kontaktimit, sa më shumë që të jetë e mundur, mbi shërbimet që tashmë janë në dispozicion, (ii) ndihmon në identifikimin e fragmentimit, boshllëqeve dhe mbivendosjeve në ofrimin e shërbimeve që duhet të adresohen në strategjinë kombëtare të kontaktimit, (iii) shërben për të identifikuar ofrues shërbimesh dhe organizata që mund të përfshihen si partnere në ofrimin e mbështetjes së përshtatur për të rinjtë e shkëputur nga tregu; dhe (iv) ofron njohuri për hartimin e standardeve minimale për organizatat partnere dhe për ofrimin e shërbimeve të kontaktimit.

Kriteret për jashtëkontraktim ndahen në tri kategori kryesore: (i) kërkesat ligjore; (ii) kërkesat operacionale dhe teknike; dhe (iii) kërkesat për ofrimin e shërbimeve.

6.1. Kërkesat ligjore

Jashtëkontraktimi në kuadër të Garancisë Rinore të Përfortuar të zbatuar në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi prokurimin publik dhe rregulloret financiare, kërkesat për regjistrim, si edhe ligjet dhe rregullat e tjera që mbrojnë të drejtat individuale (mosdiskriminimin, mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtat e punëtorëve).

Për të marrë pjesë në procesin konkurrues të tenderimit, aplikuesit duhet: (i) të jenë të regjistruar (ose të licencuar) pranë autoritetit kombëtar kompetent si organizatë e shoqërisë civile/jo-fitimprurëse, si qendër rinore lokale ose si qendër e punës/shërbimeve sociale; (ii) të kenë një fokus specifik (ose mandat) për të punuar me të rinjtë (siç përcaktohet nga statuti i organizatës); dhe (iii) të jenë në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të burimeve njerëzore (transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e buxhetit, strategji për zhvillimin e burimeve njerëzore në përputhje me parimet e legjislacionit të punës). Të gjitha kërkesat e lartpërmendura ligjore janë të detyrueshme, pa asnjë përjashtim.

6.2. Kërkesat operacionale

Organizatat aplikuese duhet të përmbushin disa kërkesa operacionale lidhur me përvojën e mëparshme, kualifikimet e stafit, mbulimin gjeografik, infrastrukturën dhe marrëveshjet e partneritetit. Është pikërisht në hartimin e kësaj pjese të procedurës së aplikimit ku hartëzimi i burimeve hyn në lojë për përcaktimin e kriterëve minimale (numri minimal i viteve të përvojës, numri minimal i stafit të kualifikuar, komunat e mbuluara, sasia dhe cilësia e infrastrukturës fizike). Më konkretisht:

- **Përvoja:** Kërkesa e parë për organizatat aplikuese është të kenë një numër minimal vitesh përvojë në organizimin e aktiviteteve të mbështetjes/angazhimit për të rinjtë (argëtim, sport, art, aftësi jetësore,

aktivitete të zhvillimit personal) dhe të kenë organizuar një numër minimal të tillë aktiviteteve në të kaluarën e afërt (për të përjashtuar organizatat që janë aktive vetëm në mënyrë sporadike). Përvoja minimale e kërkuar mund të përcaktohet duke u bazuar në hartëzimin e burimeve (për shembull, nëse shumica e organizatave të hartëzuara kanë mes tre dhe pesë vjet përvojë në aktivitete angazhimi me të rinjtë, atëherë kërkesa mund të formulohet si: “minimum tre vjet përvojë e dokumentuar në organizimin dhe ofrimin e aktiviteteve të angazhimit që synojnë të rinjtë (15–29 vjeç)”).

- **Stafi i kualifikuar:** Kërkesa e dytë për organizatat aplikuese është disponueshmëria e një ekipi me një numër minimal punëtorësh të trajnuar rinorë, punëtorësh të kontaktimit ose punëtorësh socialë (shih Shtojcën 2 për kualifikimet dhe përgjegjësitë shembull të punëtorëve të kontaktimit/rinorë). Aplikimi duhet gjithashtu të kërkojë përvojë të mëparshme në: (i) punën në terren ose kontaktimin digjital (ose gatishmërinë për t'u përfshirë në ngritje kapacitetesh për këtë qëllim); dhe (ii) ofrimin e arsimit joformal dhe mentorimit të lidhur me aftësitë jetësore dhe zhvillimin personal.
- **Shtrirja gjeografike:** Organizatat aplikuese mund të kërkojnë të kenë përvojë specifike në organizimin e aktiviteteve rinore në disa komuna apo rajone, ose të tregojnë gatishmëri për t'u përfshirë në zonat gjeografike të synuara.
- **Infrastruktura:** Aplikuesit duhet të dëshmojnë disponueshmërinë e një hapësire miqësore për të rinjtë, ku mund të organizohen aktivitetet e angazhimit dhe ofrimi i shërbimeve të brendshme. Një hapësirë e tillë mund të jetë pronë e një institucioni publik dhe/ose të ndahet me të tjerë (organizata të tjera rinore, qendër rinore, ambiente të komunës). Objekti fizik duhet të ofrojë hapësira për aktivitete të ndryshme (ndërveprim shoqëror, punëtori dhe, nëse është e mundur, një hapësirë të jashtme për aktivitete rekreative) dhe të jetë në përputhje me standardet kombëtare të shëndetit, sigurisë dhe qasshmërisë.
- **Rrjeti/marrëveshjet e partneritetit:** Aplikuesit duhet të kenë marrëveshje partneriteti ose bashkëpunimi me ofrues të tjerë shërbimesh (për shembull shkolla, qendra trajnimi, qendra të punës sociale, shërbime shëndetësore). Këto marrëveshje do të jenë të dobishme si për identifikimin (e tërthortë) të të rinjve të paangazhuar që do të përfshihen në aktivitetet e kontaktimit, ashtu edhe për referimin e përfituesve të rinj që kanë nevojë për shërbime të specializuara.

6.3. Kërkesat për ofrimin e shërbimeve

Kërkesat në këtë fushë duhet të zhvillohen mbi bazën e fazave të modelit të ndërhyrjes për kontaktim të përshkruara më sipër.

- **Kontakti:** përshkrimi dhe shpeshtësia e aktiviteteve online dhe në terren që do të organizohen nga organizata aplikuese për të kontaktuar të rinjtë e paangazhuar (fushata ndërgjegjësimi, punë në terren dhe punë e kontaktimit, partneritet me ofrues të tjerë shërbimesh) si edhe kualifikimet e punëtorëve rinorë/ punëtorëve të kontaktimit që do të menaxhojnë fazën e kontaktit.
- **Angazhimi:** përshkrimi dhe shpeshtësia e aktiviteteve me prag të ulët dhe atyre të plota që duhet të organizohen nga organizata aplikuese për të angazhuar të rinjtë (argëtim, sport, arte). Numri dhe kualifikimet e punëtorëve rinorë/ punëtorëve të kontaktimit që do të menaxhojnë fazën e angazhimit. Vendndodhja e hapësirës fizike, miqësore për të rinjtë, ku do të organizohen aktivitetet e mirëfillta të angazhimit.
- **Mbështetja e personalizuar:** përshkrimi i shërbimeve të brendshme (vlerësim i personalizuar i nevojave, plan shërbimi, këshillim zhvillues (coaching) mbi aftësitë jetësore, zhvillim personal, informim dhe këshillim për karrierën, aftësi përgatitore për punë) që aplikuesi do t'u ofrojë përfituesve të rinj; numri dhe kualifikimet e punëtorëve rinorë/ punëtorëve të kontaktimit të ngarkuar me menaxhimin e ofrimit të shërbimeve; vendndodhja dhe përshkrimi i ambienteve ku do të organizohen shërbimet e brendshme. Lista e marrëveshjeve të partneritetit dhe përshkrimi i shërbimeve që do të jenë në dispozicion përmes referimit (arsim joformal, ndihmë psikologjike, shërbime shëndetësore). Procedurat e planifikuara për

referimin e përfituesve të rinj në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore; përshkrimi i aktiviteteve të mentorimit gjatë pjesëmarrjes në Garancinë Rinore (nëse parashikohet); numri dhe kualifikimet e punëtorëve rinorë/ punëtorëve të kontaktimit të caktuar për këtë detyrë.

6.4. Kërkesat për monitorim

Ka dy lloje kërkesash për monitorim me të cilat organizatat aplikuese duhet të jenë në përputhje. Kërkesa e parë është zhvillimi i një instrumenti të brendshëm vlerësimi që është në gjendje të masë progresin e përfituesve të rinj përmes fazave të ndryshme të mbështetjes (nga angazhimi me prag të ulët deri tek angazhimi i plotë, nga angazhimi te pjesëmarrja në shërbime të personalizuar dhe gatishmëria për t'u regjistruar në sistemin e shërbimeve të Garancisë Rinore). Meqenëse qëllimi i kontaktimit është që të rinjtë NEET të arrijnë pavarësi dhe vetëmbështetje në aspekte të ndryshme të jetës (familje, shëndet, punësim, marrëdhënie me bashkëmoshatarët, arsim dhe trajnim), vlerësimi duhet të masë progresin e të riut nga gjendja fillestare e identifikuar në një fushë të caktuar të jetës (për shembull aftësi e kufizuar për të komunikuar me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, qëndrim konfrontues) deri tek rezultati i dëshiruar (për shembull demonstroi aftësi për të komunikuar me të rritur dhe bashkëmoshatarë në një mënyrë jokonfrontuese).


Kërkesa e dytë e monitorimit lidhet me treguesit e procesit dhe të rezultateve, të cilat organizata aplikuese duhet t'i mbledhë për secilën nga fazat e ndryshme të kontaktimit, siç janë përshkruar më sipër dhe janë përmbledhur në Kutinë 3.

► **Kutia 3: Përmbledhje e treguesve të monitorimit për aktivitetet e kontaktimit**

Kontakti	► Numri i të rinjve të arritur përmes aktiviteteve të “kontaktimit” (i ndarë sipas llojit të aktivitetit, si fushata në rrjete sociale, aktivitete në terren). ► Numri i të rinjve të kontaktuar përmes mënyrave të ndryshme që kanë kaluar në fazën e “angazhimit”.
Angazhimi	► Numri i të rinjve që u angazhuan në aktivitetet e disponueshme me prag të ulët (sipas grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aktivitetit). ► Numri i të rinjve që marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e angazhimit. ► Numri i të rinjve që përparojnë drejt shërbimeve të personalizuar mbështetëse (sipas grupmoshës dhe gjinisë). ► Numri i të rinjve që regjistrohen në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore (ose që angazhohen ndryshe në punësim, arsim të vazhdueshëm, trajnim ose praktikë profesionale).
Ofrimi i shërbimeve	► Numri i të rinjve që marrin vlerësim të personalizuar të nevojave (sipas grupmoshës dhe gjinisë). ► Numri i përfituesve të shërbimeve të përfshirjes (sipas llojit të shërbimit dhe kohëzgjatjes, si dhe sipas gjinisë dhe grupmoshës). ► Numri i përfituesve që referohen tek një ofrues i jashtëm shërbimesh për mbështetje (sipas llojit të shërbimit të kërkuar, gjinisë dhe grupmoshës). ► Numri i përfituesve të shërbimeve (të brendshme dhe të jashtme) të referuar në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore.
Referimi në Garancinë Rinore	► Numri i përfituesve të shërbimeve të kontaktimit që regjistrohen në Garancinë Rinore (sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor). ► Numri i përfituesve të kontaktimit të regjistruar në Garancinë Rinore dhe që marrin mentorim (sipas gjinisë dhe moshës, kohëzgjatjes së mentorimit në javë/muaj).

► Shtojca 1: Standardet minimale për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve të kontaktimit me të rinjtë

Objektivi	Përmbajtja	Metodat, mjetet dhe burimet	Treguesit e monitorimit
1. Identifikimi dhe kontakti			
Të identifikohen dhe të kontaktohen të rinjtë e paangazhuar me qëllim ofrimin e informacionit mbi mbështetjen e disponueshme.	- Aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimit - Kontakti një me një - Rrjetëzimi me ofrues të tjerë shërbimesh	Aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimit duhet të përdorin mjete të ndryshme komunikimi, si: - materiale të shtypura dhe digjitale, - faqe të internetit dhe rrjete sociale, - linja telefonike ndihmëse dhe numra pa pagesë. Kontakti një me një duhet të realizohet përmes punës në terren në zonat ku grumbullohen të rinjtë (fizikisht dhe online), si: - Qendra tregtare, - Qendra komunitare, - Salla koncertesh dhe sportive, - Famulli, qendra rinore, - Platforma online si TikTok, Facebook, Instagram, X, Viber. Rrjetëzimi me ofrues të tjerë shërbimesh, si: - Institucionet e arsimit dhe trajnimit, - Qendrat shëndetësore dhe të punës sociale, - Komunat,	► Numri i të rinjve të arritur përmes aktiviteteve të “kontaktit” (i ndarë sipas llojit të aktivitetit, si fushata në rrjete sociale, aktivitete në terren). ► Numri i të rinjve të kontaktuar përmes mënyrave të ndryshme që kanë kaluar në fazën e “angazhimit”.



- Ofrues të tjerë të specializuar (si varësitë, dhuna në familje, trafikimi, shfrytëzimi)


Kontakti duhet të kryhet nga punëtorë të kualifikuar të kontaktimit ose punëtorë rinorë, të trajnuar në mënyrë adekuate për të ofruar informacion, këshillim dhe mbështetje ndërmjet bashkëmoshatarëve.

Kërkesë kyçe: mbajtja e shënimeve për aktivitetet e “kontaktit” të organizuara dhe numrin e përafërt të të rinjve të arritur.

Shënim: Meqenëse të gjitha planet e zbatimit të Garancisë Rinore (GR) në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor mbështeten në aktivitetet e organizatave rinore të shoqërisë civile për të planifikuar dhe zbatuar fazat e ndryshme të procesit të kontaktimit, fazat e identifikimit dhe kontaktit janë të kombinuara.

Objektivi	Përmbajtja	Metodat, mjetet dhe burimet	Treguesit e monitorimit
2. Angazhimi			
T'u ofrohen të rinjve të shkëputur nga tregu mundësi angazhimi me prag të ulët dhe të plota në një hapësirë miqësore për të rinjtë	- Aktivitetet argëtuese, sportive dhe artistike - Informim, këshilla ndërmjet bashkëmoshatarëve, mentorim, këshillim dhe orientim	Aktivitetet argëtuese, sportive dhe artistike janë pika hyrëse me prag të ulët, të dizajnuara për të tërhequr të rinjtë dhe për t'i bindur ata të marrin pjesë në aktivitete të tjera të organizuara për të nxitur mësimin joformal, zhvillimin personal dhe aftësitë jetësore. Informimi, këshillimi, mentorimi dhe orientimi duhet të përdorin teknika të ndryshme, si: - Këshillimi zhvillues (coaching) - Teknikat e ndryshimit të sjelljes - Dëgjimi aktiv - Pyetjet me vlerësim në shkallë Aktivitetet e angazhimit duhet të realizohen nga punëtorë të kualifikuar të kontaktimit ose punëtorë rinorë, të trajnuar në mënyrë adekuate në këshillim dhe në teknikat e ndryshimit të sjelljes. Kërkesë kyçe: - Një hapësirë fizike ku mund të organizohen aktivitetet e angazhimit me prag të ulët dhe ato të plota, në përputhje me standardet kombëtare të shëndetit, sigurisë dhe qasshmërisë.	► Numri i të rinjve që u angazhuan në aktivitetet e disponueshme me prag të ulët (sipas grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aktivitetit). ► Numri i të rinjve që marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e angazhimit. ► Numri i të rinjve që përparojnë drejt shërbimeve mbështetëse të personalizuar (sipas grupmoshës dhe gjinisë). ► Numri i të rinjve që regjistrohen në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore (ose që angazhohen ndryshe në punësim, arsim të vazhdueshëm, trajnim ose praktikë profesionale).

- Udhëzues mbi përcaktimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve për kontaktimin (outreach) e të rinjve në kontekstin e Garancisë Rinore



- Një formular elektronik regjistrimi ku regjistrohen dhe mirëmbahen të dhëna të rëndësishme për përfituesit.

Objektivi	Përmbajtja	Metodat, mjetet dhe burimet	Treguesit e monitorimit
3. Shërbimet mbështetëse të personalizuara			
Të ofrohen për të rinjtë e shkëputur nga tregu shërbime përfshirëse të përshtatura sipas nevojave individuale.	• Vlerësim i personalizuar i nevojave • Shërbime për rritjen e motivimit, vetëvlerësimit dhe vetëdijes • Trajnim mbi aftësitë bazë të punësueshmërisë (komunikim, punë në grup, menaxhim kohe, mendim kritik) • Informacion dhe këshillim për karrierën • Referim (dhe shoqërim) te shërbimet e specializuara	Shërbimet që duhet të ofrohen brenda organizatës partnere (in-house): Vlerësimi i personalizuar i nevojave duhet të realizohet përmes një pyetësori të strukturuar për të identifikuar sfidat në dimensione të ndryshme të jetës (arsim, familje, shëndet, punësim). Ky proces duhet të çojë në një plan veprimi dhe planifikim të ofrimit të shërbimeve. Trajnim dhe këshillim zhvillues (coaching) mbi aftësitë jetësore (seanca grupore dhe individuale): menaxhimi i emocioneve dhe zemërimit, zgjidhja e problemeve, marrja e vendimeve, vendosja e qëllimeve, shëndeti dhe mirëqenia (përfshirë shëndetin seksual), vetëkuptimi, identiteti social, empatia, marrëdhëniet, aftësitë e socializimit. Aftësi për botën e punës (trajnim ose këshillim zhvillues (coaching), një me një ose në grup): komunikim, punë në ekip, aftësi përgatitore për punë. Informacion dhe këshillim për karrierën (individualisht ose në grup, ballë për ballë ose online) për të ndihmuar të rinjtë të marrin vendime të informuara për arsim, trajnim ose punësim. Përvoja provuese në punë (work tasters) (opsionale): periudha të shkurtra mësimi të organizuara në një shkollë profesionale ose qendër trajnimi, për të praktikuar detyrat e një pune me qëllim zgjedhjen e një profesioni. Shërbimet e personalizuara duhet të ofrohen nga punëtorë rinorë ose punëtorë të kontaktimit të kualifikuar dhe me përvojë, të trajnuar posaçërisht në përmbajtjen e secilit shërbim. Kërkesë kyçe: Disponueshmëria e një instrumenti për vlerësim individual (profilizim), një model plani shërbimesh, përshkrimi i shërbimeve që do të ofrohen (objektivat, përmbajtja, kohëzgjatja e përafërt, stafi i caktuar dhe niveli i kompetencës) si dhe rezultatet e pritshme.	► Numri i të rinjve që marrin një vlerësim të personalizuar të nevojave (sipas grupmoshës dhe gjinisë). ► Numri i përfituesve të shërbimeve të përfshirjes (sipas llojit të shërbimit dhe kohëzgjatjes, si dhe sipas gjinisë dhe grupmoshës). ► Numri i përfituesve që referohen tek një ofrues i jashtëm shërbimesh për mbështetje (sipas llojit të shërbimit të kërkuar, gjinisë dhe grupmoshës). ► Numri i përfituesve të shërbimeve (të brendshme dhe të jashtme) të referuar

		Përdorimi i instrumenteve vlerësuese përfundimtare për të përcaktuar gatishmërinë e individëve për të kaluar në sistemin e shërbimeve të Garancisë Rinore. Shërbimet e jashtme Referimi te shërbimet (e jashtme) përfshin: • Shërbime shëndetësore (sëmundje, aftësi të kufizuara, shëndet mendor, varësi, fertilitet dhe kontracepsion) • Shërbime të ofruara nga qendrat e punës sociale (strehim, varfëri, kujdes për fëmijët ose të moshuarit, transport) • Shërbime të ofruara nga agjenci/organizata të specializuara (rehabilitim për varësitë, shërbime për viktimat e dhunës në familje, trafikimit, forma të tjera shfrytëzimi) Mekanizmi i referimit duhet të dëshmohet përmes marrëveshjeve të partneritetit. Të gjitha informacionet që lidhen me përfituesit dhe shërbimet e ofruara duhet të regjistrohen dhe ruhen në format elektronik.	në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore.
--	--	---	--

Referimi në sistemin e ofrimit të shërbimeve të Garancisë Rinore

Të motivojë dhe përgatisë përfituesit e rinj të aktiviteteve të kontaktimit për të marrë mbështetje më intensive dhe të orientuar drejt qëllimit, për t'u kthyer në	• Referim (dhe shoqërim) në procesin e regjistrimit në Garancinë Rinore • Mentorim gjatë pjesëmarrjes në Garancinë Rinore (opsionale)	Vlerësimi i gatishmërisë kryhet në mënyrë vullnetare nga vetë i riu dhe përfshin një vetëvlerësim si dhe një vlerësim nga punëtorë të kualifikuar të kontaktimit ose punëtorë rinorë. Punëtorët e kontaktimit/rinorë ofrojnë informacion mbi Garancinë Rinore (objektivat, detajet e shërbimeve që ofrohen, çfarë të pritët në lidhje me angazhimin individual). Referimi dhe shoqërimi në regjistrimin në Garancinë Rinore duhet të bëhet nga punëtorë rinorë/ punëtorë kontaktimi të kualifikuar, për të ndihmuar të riun të përmbushë kërkesat për regjistrim në Garancinë Rinore (online ose fizikisht) dhe për të marrë pjesë në intervistën e parë të këshillimit. Një përmbledhje e aktiviteteve dhe shërbimeve tashmë të ofruara i dorëzohet punëtorët të rastit të ShPP-it për të shmangur dyfishimin e asistencës.	► Numri i përfituesve të shërbimeve të kontaktimit që regjistrohen në Garancinë Rinore (sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit të arsimit). ► Numri i përfituesve të kontaktimit të
--	--	---	--

arsim/trajnim
ose për t'u futur
në tregun e
punës.

Mentorimi gjatë pjesëmarrjes në Garancinë Rinore (opsionale): punonjësi i kontaktimit ose rinor mban kontakte periodike me përfituesin e ri për t'i ofruar këshilla, inkurajim dhe këshillim zhvillues (coaching) për të përfunduar rrugëtimin në Garancinë Rinore.

Referimi dhe mentorimi duhet të realizohen nga punëtorë rinorë ose punëtorë të kontaktimit të kualifikuar.

Kërkesë kyçe: mbajtja e shënimeve për referimet në Garancinë Rinore dhe mentorimin e ofruar.

regjistruar në
Garancinë Rinore
dhe që marrin
mentorim (sipas
gjinisë dhe moshës,
kohëzgjatja e
mentorimit në
javë/muaj).

► Shtojca 2: Përgjegjësitë, kualifikimet dhe aftësitë e punëtorëve rinorë dhe të kontaktimit

Një punëtor rinor i kontaktimit identifikon, angazhon dhe ndërton marrëdhënie besimi me të rinjtë e shkëputur nga shoqëria, tregu i punës dhe sistemi i mbështetjes së tyre, duke punuar njëkohësisht me burimet lokale për të hequr pengesat dhe për të krijuar mundësi për zhvillim personal, pavarësi dhe vetëmjaftueshmëri.

Përgjegjësitë


- Të punojë në bashkëpunim me partnerët e komunitetit për të identifikuar të rinjtë që kanë nevojë për mbështetje.
- Të ofrojë kontaktim proaktiv në zonat ku dihet se mbledhen të rinjtë, si online ashtu edhe përmes punës në terren.
- Të ndërtojë marrëdhënie besimi dhe të ofrojë mentorim për të rinjtë që janë identifikuar si në rrezik.
- Të vlerësojë nevojat e të rinjve për të planifikuar dhe ofruar në mënyrë të saktë shërbime dhe programe në fusha si shëndeti, trajnimi, punësimi dhe marrëdhëniet.
- Të krijojë dhe të udhëheqë aktivitete rekreative dhe artistike, projekte komunitare/mjedisore, aktivitete rezidenciale, edukim në natyrë dhe aktivitete sportive.
- Të zhvillojë një marrëdhënie me të rinjtë të bazuar në respekt dhe besim, duke siguruar që ata të kenë një hapësirë të sigurt për të zhvilluar identitetin e tyre.
- Të vendosë kufij dhe të sfidojë sjelljet e papërshtatshme.
- Të mbështesë të rinjtë në mjedise të ndryshme, përfshirë edhe punën e kontaktimit.
- Të mentorojë, trajnojë dhe mbështesë individët, duke inkurajuar një përfshirje më të madhe shoqërore.
- Të vendosë objektiva për progresin dhe të monitorojë e rishikojë rregullisht cilësinë e shërbimeve rinore lokale.
- Të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie pune pozitive e produktive me partnerët e komunitetit, përfshirë sistemin arsimor, organet e rendit dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe të punësimit.
- Të punojë në partneritet me familjet dhe persona të tjerë kyç në jetën e të rinjve, si dhe me profesionistë nga organizata të tjera që merren me të rinjtë, si shërbimet sociale, shëndeti, arsimi dhe autoritetet lokale, për të ndërtuar një rrjet të fortë mbështetjeje.
- Të kryejë detyra administrative, të mbajë sisteme efektive të regjistrimit dhe të përgjigjet ndaj kërkesave.
- Të sigurojë dokumentim të vazhdueshëm për aktivitetet e programit, mbështetjen individuale dhe rastet kritike.

Kualifikimet

- Diplomë universitare në punë sociale, kujdes për fëmijë dhe të rinj, psikologji, ose në një fushë tjetër të shkencave sociale apo shëndetësore.
- Certifikim profesional ose licencim nga organi rregullator kompetent (nëse kërkohet).
- Përvojë e mëparshme pune në ndonjë mjedis të shërbimeve sociale.

Aftësitë

- Angazhim i fortë ndaj të rinjve dhe kuptim i faktorëve që ndikojnë në jetët e tyre.
- Aftësi për të ofruar mbështetje të besueshme për të rinjtë dhe për të vepruar me integritet në kohë stresi.
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale, me aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie të mira me të rinjtë.
- Njohuri mbi shërbimet dhe burimet e komunitetit.
- Durim, tolerancë dhe fleksibilitet.
- Fleksibilitet në orarin e punës dhe përballjen me prioritetet të ndryshueshme.
- Aftësi për komunikim formal për prezantime dhe shkrim raportesh.
- Aftësi për të trajtuar shqetësimet e të rinjve me respekt, takt dhe ndjeshmëri, duke qenë i vetëdijshëm për kufijtë që kërkohen nga konfidencialiteti dhe kufijtë që rregullojnë marrëdhënien mes të rinjve dhe punëtorët rinor.
- Qëndrueshmëri, integritet personal dhe profesional.
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip, duke demonstruar qëndrim miqësor dhe pozitiv.
- Interes për sportin ose artet skenike, jo e domosdoshme, por e dobishme për angazhimin e grupeve rinore dhe lehtësimin e aktiviteteve.



ilo.org

International Labour Organization
Mozsár utca 14.
Budapest 1066
HUNGARY

f International Labour Organization
t @ILO
y ILOTV